Prishtinë, arrestohet një i dyshuar për ngacmim seksual
Zjarri në IML dyshohet se u shkaktua nga një defekt në instalimin elektrik
Tentoi t'i korruptonte policët kufitarë në Jarinjë me 10 euro, iniciohet rast ndaj të dyshuarit
Dënohet me gjobë sulmuesi i gazetarit Krasniqi në Prizren
Kapet mall i kontrabanduar në vlerë prej 25.000 eurosh
Theret me thikë një i mitur në Lipjan
E mitura në Ferizaj raporton babanë se e ka sulmuar seksualisht
Vetëvritet një person në Prishtinë
Digjen dy zyra në Institutin e Mjekësisë Ligjore
Banda shqiptare e drogës, që adhuronte "Scarfacen" e Al Pacinos, dënohet me 71 vjet burgim
Përfshihen nga zjarri objektet ndihmëse prapa "Ibër-Lepencit" në Prishtinë
Në Gjilan u tentua të vidhej me eksploziv një bankomat

Të lënduarit nga granata e dorës në Prizren, jashtë rrezikut për jetën

Foto: TV Prizreni

10:02
Të lënduarit nga granata e dorës në Prizren, jashtë rrezikut për jetën
09:31
Nëntë të lënduar nga hedhja e granatës së dorës në tregun e kafshëve në Prizren

22 nëntor 2023, 09:31

10:02 Të lënduarit nga granata e dorës në Prizren, jashtë rrezikut për jetën

Pesë nga të lënduarit në tregun e kafshëve në Prizren janë dërguar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, pas hedhjes së një granate dore në orët e para të së mërkurës.

Shefi i Emergjencës në Prizren, Hekuran Veçgishti, ka konfirmuar për KOHËN se katër të tjerët janë liruar për në shtëpi.

"Fillimisht, kanë ardhur nëntë persona. Më pas, ka ardhur edhe një. Katër prej tyre janë liruar, pesë janë dërguar në QKUK pasi kanë pas lëndime që s'trajtohen në Spitalin tonë", ka thënë Veçgishti.

Drejtori i Emergjencës në QKUK, Naser Syla, ka thënë për KOHËN se të plagosurit nga granata e dorës në tregun e kafshëve në Prizren janë jashtë rrezikut për jetë e se kanë marrë lëndime të lehta në trup. Ai ka thënë se dy pacientë po trajtohen në QKUK.

09:31 Nëntë të lënduar nga hedhja e granatës së dorës në tregun e kafshëve në Prizren

Nëntë persona janë lënduar nga shpërthimi i një granate dore në tregun e kafshëve në Prizren në mëngjesin e së mërkurës, ka konfirmuar Policia e Kosovës.

Të gjithë të lënduarit janë dërguar në Emergjencën e Spitalit Rajonal të Prizrenit.

Tre të dyshuarit janë identifikuar dhe janë në kërkim policor.

"Sot me datë 22.11.2023, rreth orës 04:50, Policia ka pranuar informatë për një rast plagosje te tregu i kafshëve në Prizren. Nga informatat e para dyshohet se 9 persona kanë pësuar lëndime nga shpërthimi i një granate dore. Të gjithë të lënduarit janë në Emergjencën e Spitalit Rajonal të Prizrenit duke marrë trajtim mjekësor. Policia ka dalë në vendngjarje dhe është informuar prokurori kujdestar gjithashtu. Në vendngjarje kanë dalë edhe njësiti i hetimeve rajonale të Prizrenit dhe janë duke mbledhur provat dhe dëshmitë. Tre te dyshuar janë identifikuar dhe janë në kërkim policor", ka thënë zëdhënësi i Policisë në rajonin e Prizrenit, Vesel Gashi.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Taboola Feed

Qetësoni dhimbjen e kockave dhe të muskujve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë



Owning A Villa In Dubai Might Not Be As Costly As You Think
Villas in Dubai | Search Ads | Sponsored



Accident in Vore? Lawyers in The Area May Be What You Need
Accident Lawyer | Search ads | Sponsored

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë



Empower Your Career Journey with Online Education
Education made easy online.
Online Degrees | Search Ads | Sponsored
Search Now

Mother sold her daughter's old bed. 3 days later the buyer made an incredible…
Women's Method | Sponsored

TË FUNDIT

Prishtinë, arrestohet një i dyshuar për ngacmim seksual

Zjarri në IML dyshohet se u shkaktua nga një defekt në instalimin elektrik

Tentoi t'i korruptonte policët kufitarë në Jarinjë me 10 euro, iniciohet rast ndaj të dyshuarit

Dënohet me gjobë sulmuesi i gazetarit Krasniqi në Prizren

Kapet mall i kontrabanduar në vlerë prej 25.000 eurosh

Theret me thikë një i mitur në Lipjan

E mitura në Ferizaj raporton babanë se e ka sulmuar seksualisht

Vetëvritet një person në Prishtinë

Digjen dy zyra në Institutin e Mjekësisë Ligjore

Banda shqiptare e drogës, që adhuronte "Scarfacen" e Al Pacinos, dënohet me 71 vjet burgim

Përfshihen nga zjarri objektet ndihmëse prapa "Ibër-Lepencit" në Prishtinë

Në Gjilan u tentua të vidhej me eksploziv një bankomat

Partnerët: Shkabaj

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfardëso mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të kenë gabime!